REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALËSE - IZLAZNA
Nr/Br: 01-461
Më/Dana: 18.09.2018
NOVOBËRDË - NOVO BRDO

# Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

**Komuna e Novobërdës**

Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

---

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

---

**Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës**
Z/znj______________________________

**Në bazë të dispozitave te nenit 44.1 pika Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.**

## F T O J

Mbledhjen e nëntë të rregulltë të K.K-së,s, e cila do të mbahet më **27.09.2018** (e enjte ) duke filluar në ora **11:00.**

## R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Aprovimi i bugjetit për vitin 2019/21;
3. Shqyrtimi i propozim të Planit Aksional për përmisimin e pozitës së gruas dhe Barazis gjinore në Komunën e Novobërdës për 2019/21;
4. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ne lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

**Më: 18.09.2018**
**Në: Novobërdë**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
KUVENDI I KOMUNËS - SKUPŠTINA OPŠTINE

**Nebojsa Arsic**
**Kryesues i Kuvendit**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALËSE - IZLAZNA
Nr/Br: 01-460
Më/Dana: 18.09.2018
NOVOBËRDË - NOVO BRDO

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosova
**Komuna e Novobërdës**
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tetë e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 06.09.2018, duke filluar në orën 11.00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryetari i Komunës Svetislav Ivanovic, Kryesuesi Nebojsa Arsic, Nënkryetari për Komunitete Bajrush Ymeri, anëtarët e Kuvendit: Negovan Jovanovic, Ivica Cenic, Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Xhejlane Behluli, Abdyl Gashi, Ramush Mehmeti, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Drejtorët e Drejtorive Komunale, zyrtar komunal si dhe një numër i qytetarëve.

Kryesuesi Nebojsa Arsic pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojm me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë të gjithë anatërt e Kuvendit 13 gjithësej pasi që dy antarë të Kuvendit kan kaluar në pozita tjera dhe ende nuk janë qertifikuar nga KQZ-ja anatërt në radhë andaj po fillojm mbledhjen me këtë:

### Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Konstatimi për Zv.Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Novobërdës, sipas Nenit 54, të Ligjit të Vetëqeversisjes Lokale;
3. Draft Buxheti për vitin 2019/2021;
4. Raporti mbi përfundimin e korrje-shirjeve për vitin 2018;
5. Raporti i drejtoris së shëndetsis në komunërn e Novobërdës, me pyksinim në Ambulancën e Llabjanit;
6. Problemi me furnizim me rrymë në teritorin e Komunës së Novobërdës;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit a pajtohen më këtë rend ditë apo keni ndonjë propozim ose diskutim?.

Xhejlane Behluli pasi përshendeti të pranishmit tha: kërkoj nga ju Kryesues që piken e dytë nga rendi i ditës ta tërhiqni dhe të caktohet në mbledhje të radhës pasi që ende nuk është ardhur vendimi nga KQZ për betimin e dy antarëve të rinjë të LDK-ës pasi që jan liruar dy vende andaj kisha kërkuar që të shtyhet dhe kur të bëhet betimi i dy antarëve të rinjë atëher të zgjidhet zv.Kryesuesi, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: nuk e kuptoj arsyen e shtyerjes pasi që z.Kryesuesi nuk ka nevoj te votohet por zgjidhet në bazë të Ligjit për Vetqeverisje Lokale.

Selatin Nuhiu pasi përshendeti të pranishmit tha: nuk pajtohem me propozimin që të tërhiqet kjo pikë nga rendi i ditës, pasi që kjo pikë nuk ka nevoj për vota, po e kuptoj që mungojn dy antarë por nuk ka nevoj të votohet dhe skemi arsye për ta shtyr këtë pikë, ju faleminderit.

Ramush Mehmeti pasi përshendeti të pranishmit tha: nuk po e kam të qartë kërkesen, megjithat e keni ligjin përpara dhe nuk ka se pse të diskutohet kjo tem, antarët të Kuvendit i përfundon mandati në atë moment që jep dorëheqje, me vet faktin që nuk jan prezent pozita e zv.Kryesuesit është e liruar dhe nuk shof asnjë penges këtu, ju faleminderit.

Xhejlane Behluli tha: po kërkoj diqka dhe nuk kam diçka kunder e as personale as partiake, është mendimi im dhe a merr vota apo jo është vendim i antarëve të Kuvendit, ju vendosni zt.Kryesuesi pasi ju jeni udhëheqës i mbledhjes, ju faleminderit.

Abdyl Gashi pasi përshendeti të pranishmit tha: më sa duket zëvendesimi i zv.kryesuesit shkon me automatizëm dhe nuk kemi të bëjm as me vota as me antarë të Kuvendit, përderisa Kryesuesi e ka atë mundësi ta bëjë në këtë mbledhje pse ta shtym për mbledhje të ardhshme dhe unë nuk pajtohem që të tërhiqet kjo pikë përderisa në nuk e përcaktojm zgjedhjen e kësaj pozite, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: nuk kem arsye për shtyerje të kësaj pike pasi qe kjo pozit zgjidhet me automatizem dhe nuk.

Pasi nuk pat diskutime tjera rendi i dites u aprovua më 12 vota për dhe 1 kunder (Xhejlane Behluli).

**Pika e parë:** Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Pasi nuk pat vërejtje proceverbali u votua njëzëri nga të gjithë antarët prezent.

**Pika e dytë:** Konstatimi për Zv.Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Novobërdës, sipas Nenit 54, të Ligjit të Vetëqeversisjes Lokale;

Kryesuesi tha: në bazë të nenit 54 të Ligjit për Vetqeverisje Lokale, në Komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve joshumicë, posti i zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve. Postin e zv.Kryesuesit e mban kandidati joshumicqë ka marrë më së shumti vota në listen e hapur për zgjedhje në Kuvendin e Komunës, andaj sipas këtyre që u tha në listat e KQZ kandidati me numër më të madhë të votave është Ramush Mehmeti dhe nga mbledhja e sotit zgjidhet zv.Kryesues i Kuvendit.

Pasi nuk pat diskutime u pru ky:

**V E N D I M**

**RAMUSH MEHMETI** konfirmohet Zëvendës Kryesues i Kuvendit Komunal Novobërdë.

Kryetari i Komunës Svetislav Ivanovic pasi përshendeti të pranishmit tha:dëshiroj të uroj Ramush Mehmetin për poziten të cilen u zgjedh zv.Kryesues i Kuvendit i uroj punë të mbarë dhe shumë suksese, ju të gjithë e dini që kjo pozit zgjedhet në bazë të Ligjit për Vetqeverisje Lokale dhe unë shpresoj se do të keni një bashkpunimë të mirë për një punë të përbashkët më të mirë, ju faleminderit.

Ramush Mehmeti tha: faleminderit qytetarëve të Komunës të cilët ma kan dhën mundësin të jem pjesë e këtij insitucioni politik, do të mundohem tju sherbej qytetarëve pa dallime etnike dhe partiake, do të mundohemi të bëjm maksimumin për një punë më të mirë për të gjithë qytetarët, ju faleminderit.

**Pika e tretë:** Draft Buxheti për vitin 2019/2021;

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalen Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic pasi përshendeti të pranishmit tha: me materila e keni marrë draft buxhetin për vitin 2019/21 dhe ky Propozim buxheti deri në fund të shtatorit duhet të aprovohet, buxheti në total është mbi 2 milon euro, kemi rritje të buxhetit krahasur me vitin e kaluar, të hyrat vetanake janë për vitin ardhshëm janë 274,583 € paga dhe meditje jan planifikuar 1,903,481€, për mallra dhe sherbime 309,716€, për shpenzime komunale 66.000€, për subvencione 30.000€ dhe shpenzime kapitale 472,442€, i kemi disa propozime që i kemi dhënë si Drejtori për shpenzime kapitale por ato do ti finalizojm pas dëgjimeve publike me qytetarë do ti finalizojm, ky draft buxhet nuk është përfundimtar por do te kemi parasysh edhe kërkesat e qytetarëve në dëgjime publike, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli tha: pasi që është edhe Kryetari prezent kisha kërku që ti keni parasysh kërkesat në dëgjime publike dhe shpresoj se kur të aprovohet buxheti të jen pjesë e planifikimit buxhetor edhe prioritetet e qytetarëve, ju faleminderit.
Sercan Todorovic tha: kërkesat e qytetarëve më së shumti janë për asfaltim të rrugëve, rregullim të kanalizimieve do ti shikojm prioritetet dhe ato që kem mundësi ti mbulojm do ti vendosim në planifikim buxhetor.
Abdyl Gashi tha: në shendetësi dhe arsim nuk ka asnjë buxhet shtesë, mendoj se gjendja në shendetësi është emergjente dhe prioriteti i Komunës duhet me qenë në shendetësi dhe arsim e pastaj të fukosohemi në drejtime tjera dhe mendoj se duhet të na dërgoni edhe projektet tjera kapitale në mënyr që ti kemi pas të hyrave dhe shpenzimeve për ti krahasuar këto shuma me projektet kapitale të cilat jan planifikuar, ju faleminderit.
Ramush Mehmeti tha: besoj se gjatë muajit shtator do të kemi një degjim publik të organizuar nga Kuvendi dhe pasi ti marrim të gjitha kërkesat e qytetarëve, KPF është obligative së bashku më Kryetarin e Komunës ta hartojn listen e prioriteteve, mendoj që në këtë formë ne duhet të mundohemi ti plotësojm kërkesat e qytetarëve aq sa kem mundësi me këtë buxheti që e kemi, ju faleminderit.
Kryesuesi tha: nese nuk ka diskutime tjera tju njoftoj se deri me 15 shtator Kuvendi është i obliguar që të mbaj një debat publik me antarët dhe qytetarët e Komunës sonë andaj ne do të caktojm një datë sot, a keni ndonjë propozim se në cilen datë të mbahet debati publik?.
Abdyl Gashi tha: mendoj se debatet të cilat jan organizuar në të kaluaren pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë shumë e dopët, mendoj se njoftimet duhet të jen më të sigurta për të gjithë qytetarët për debatet të cilat mbahen dhe në një mënyrë të sigurohet edhe transporti nese mbahet në Kuvend dhe mendoj se debatet të cilat mbahen të ken seriozitete më të madhë, qyetarët të ken mundësi ti paraqesin kërkesat prej vendbanimeve të tyre dhe mos të jen debate vetem sa për ta plotësuar rregulloren e nivelit qendror, ju faleminderit.
Kryesuesi tha: a pajtoheni që të mbahet degjimi publik me datë 11 shtatorë?.
Abdyl Gashi tha: dëgjimet publike që jan mbajt më herët kan qenë prej orës 10 dhe nuk është orar i përshtatshëm që qytetarët të marrin pjesë, mendoj qe këto debate duhet të mbahen pas orës 13 në mënyrë që pjesëmarrja e qytetarëve të jetë më e madhe, ju faleminderit.
Kryesuesi tha: atëher po e caktojm të marten me 11 shtatorë prej ores 13 në sall të Kuvendit.
**Pika e katërt:** Raporti mbi përfundimin e korrje-shirjeve për vitin 2018;
Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalen ZDBPZHR Avdi Vllasaliu.
Avdi Vllasaliu pasi përshendeti të pranishmit tha: pasi që materialin të gjithë e keni marrë me kohë do tju informoj shkurtimisht rreth procesit të korrje-shirjeve për këtë vit. Procesi i korrje-shirjeve ka filluar me datë 04.07.2018 dhe ka përfunduar me datë 10.08.2018 gjatë këtij procesi nuk kemi pasur probleme as nga ana e qytetarëve dhe as nga autokombanjereve, çmimi ka qenë i caktuar 100€. Këtë raport e kemi derguar edhe në Ministri të Bujqësisë, nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.
Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.
Pasi nuk pat diskutime aprovohet njëzëri nga të gjithë antarët prezent të Kuvendit kjo pikë dhe u pru ky:

**V E N D I M**

**APROVOHET** Raporti mbi përfundimin e korrje-shirjeve për vitin 2018.

**Pika e pestë:** Raporti i drejtoris së shëndetsis në Komunën e Novobërdës, me pyksinim në Ambulancën e Llabjanit;
Kryesuesi tha: pasi që Drejtori i Shendetësisë ka pasur disa punë në Ministri të Shendetësis dhe nuk ka mundur të merrë pjesë në mbledhje na ka pregaditur një raport dhe na ka dergur të cilin do ta lexoj unë për tju njoftuar rreth gjendjes së shendetësisë në Komunënë tonë. Të gjithë e dim gjendjen e mjerueshme në të cilen ndodhet shendetësia në Komunënë tonë por ne jemi munduar që gjërat elementare ti sikgurojm dhe të gjitha ambulantat ti paisemi me material, ndërsa sa i përketa ambulantes së rë në fshatin Llabjan

ende nuk është bërë pranimi teknik pasi që ende nuk ka përfunduar në tërsi dhe e kisha lutur Nenkryetrin për Komunitete Bajrush Ymerin që tju informoj më shumë rreth kësaj ambulante pasi që ka qenë i kyçur qysh nga fillimi.

Nënkryetari për Komunitete Bajrush Ymeri pasi përshendeti të pranishmit tha: siç e dini në këtë Kuvend Komunal ne kemi marrë një vendim për ndarjen e një parcele për nërtimin e ambulante në fshatin Llabjan, pas ndarjes së parceles organizata e cila ka shprehur gadishmerin për ta financuar ndërtimin e kësaj ambulante ka filluar punimet dhe kanë përfunduar këtë vit, dmth objekti është i përfunduar gjithashtu edhe rrethoja e objektit, neve si Komunë na kan mbetur disa obligime pa i përfunduar si kyçja në kanalizimi dhe ujësjellës, meqë ujësjellësi nuk është funksional për momentin ne kemi kërkuar nga organizat që të bëjë shpuarjen e një bunari për ambulant dhe bunari është hap vetem edhe pompa duhet të vendose dhe kyçja në ujë do të përfundoj shpejt ndërsa sa i përket kanalizimit është pak problem për arsye se organizata e cila e ka ndërtuar e ka vendosur kanalizmin 10m nga ambulanat dhe pjesa tjetër ka mbetur obligim i Komunës, ne këtyre ditëve e kemi një projekt të hapur për ndërtim të kanalizimeve dhe besoj që do të rregullohet edhe te ambulanta dhe pasi që edhe Kryetari është prezent kërkoj që të na ofroj mbështetje për ta paisur me inventar, do të bisedoj edhe me stafin e ambulantes në Novobërdë që ato paisje që i kan në ambulanten egzistuese ti dergojn ne ambulanten e re, pasi që objketi i ri është shumë më i madhë se objekti egzistues në Llabjan pasi që deri më tani i ka kryer funksionet e veta po tash që vendbvanimi është rrit konsideroj që ambulanta e re i plotëson kushtet mjaftueshëm për këtë numër të banorëve dhe së shpejti pasi të kyçet në kanalizim ambulanat mundet të funksionalizohet, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: unë si antarë i KPF ne sencen e fundit kam kërkuar/propozuar si pikë për rend të ditës të diskutohet pasi që jemi në kohen e hartimit të buxhetit dhe ne raport të Kryetarit jnaë permendur vështërsit ne sektor të shendetësisë dhe arsimit, e falemenderoj Drejtorin që ka dërguar raportin, falemenderoj edhe Kryetarin që na dha sqarime shtesë, andaj unë kisha kërku që ti kemi prioritet këto sektore që ti ndajm buxhet prej të hyrave vetanake pasi që gjendja është e mjerueshme, kam qenë një ditë në abmulanten në Novobërdë të mjeku dhe nuk kan pasur as anastezion, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: e shoh si problem pasi që Drejtori përkatës nuk është këtu dhe pyetjet për shëndetësi ti drejtohen Nenkryetarit apo Kryesuesit andaj kisha kërku të dij se sa është siperfaqja e ambulantes së re dhe sa është ajo e ambulantes së vjetër në Artanë, më sa duket nga jasht nuk i plotëson kushtet për të kryer sherbime shendetësore, kam pas rastin ti vizitoj qendrat e QKMF dhe kam parë se aty mungojn fashat dhe jodi, mungon edhe fletpranimi ku shkruhen të dhënat e duhura për pranim të pacientit perderisa ne Komunat tjera tjera janë bërë edhe kontrollat sistematike për kontrollim të nxënësve që mundë të kenë ndonjë sëmundje, perderisa nuk kemi shumë banorë kishte qenë e mirë që të fillojm më këtë praktikë edhe në Komunën tonë një kontroll sistematike në të gjitha shkollat, mendoj se me këtë sistem ku shendetësia dhe arsimi mbeten anash nuk shoh ndonjë prioritet tjetër në asfaltim të ndonjë rruge përderisa nuk mirren me shendetin e qytetarëve dhe me arsimin cilësor, ju faleminderit.

Xhejlane Behluli tha: propozimi për këtë parcel ka ardhur pikërisht nga Nenkryetari për Komunitete ku ai na përfaqëson të gjithë ne,po flas prej mandatit të kaluar ku kam qenë pjesë e KPF për 10 muaj. Është mirë me qenë edhe Drejtori i shendetësisë prezent por pasi që një Nënkryetar përcjell punën është punë e mire, vetem të njoftova pasi që nuk ke qenë pjesë e Kuvendit mandatin e kaluar ndërsa sa i përket furnizimit të ambulantave më material ne para mbledhjes bisedum dhe e kuptum se janë furnizuar me material.

Abdyl Gashi tha: mendoj se nuk është mirë të marrësh barren për një Drejtor që është përgjegjës për punën e shëndetësisë pasi që secili prej nesh mundet me qenë përcjellës, mundet të ndihmoj por përgjegjës mundet me qenë Drejtori përkatës që mirret me atë punë.

Xhejlane Behluli tha: edhe ne si antarë të Kuvendit duhet të interesohemi nese një kërkesë e jona është realizuar, nese janë plotësuar kushtet me material atëher nuk kemi se çka të diskutojm dmth mungon vetem informata se mos e merr diçka personale, ju faleminderit.

Kryetari i Komunës Svetislav Ivanovic tha: po diskutohet për ambulanten në Llabjan dhe une së pari e falemenderoj Donatorin i cili na ka ndihmuar, edhe pse Drejtori nuk është prezent informata ju dha të gjithëve, ne e kemi ambulanten dhe ne do të mundohemi maksimalisht jo vetem me vendim të Kuvendit por do ti shohim të gjitha mundësit për të gjitha ambulantat që të krijojm infrastruktur për funksionalizim më të mirë, kemi probleme edhe më të mëdha mos të fokusohemi vetem te ambulanta dhe kemi nevoj edhe për shumë gjëra që të përmirësohen, ju faleminderit.

**Pika e gjashtë:** Problemi me furnizim me rrymë në teritorin e Komunës së Novobërdës;

Kryesuesi tha: i kemi disa probleme me furmizim me rrymë në disa fshatra të Komunës tonë, këtë problem e ka paraqitur Ramush Mehmeti dhe ja dha fjalen që të na ofroj më shumë informata.

Ramush Mehmeti tha: mendoj se jemi dëshmitarë të gjithë qytetarët e Komunës pasi që Novobërda është lënë shumë pas dore sa i perket KEDS-it, ideja rreth këti problemi është që ne si Kuvend të parashtrojm një kërkes dhe atë kërkesë ta parashtroj Kryetari i Komunës dhe Nenkryetari për Komunitete dhe të tregon se në Novobërdë njësia për rrym është larguar, paramendoni vetem për një sigures për ta lëshuar rrymen presmi deri 5 ose 6 orë, kjo është totalisht një padrejtësi ndaj qytetarëve pasi ne bëjëm pagesat e rrymes pse mos me qenë kjo njësi, andaj ne si Kuvend ta ngrsim zërin pasi që KEDS-i kërkon pagesë edhe ne qytetarët kërkojm shërbim, ju faleminderit.

Dobrivoje Djordjevic pasi përshendeti të pranishmit tha: në Stanishor jan hapur dy fabrika dhe janë kyçur në tarifat egzistuese, dhe kur fillojn të punojn fabrikat, ne nuk mundë të punojm asgjë më rrym pasi që bie tensioni i rrymës, andaj kishte qenë mirë që të kenë kyçje në ndonjë trafë tjter, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: atëher në të marrim një vendim që të dërgojm një shkresë në KEDS përmes D.SH.P për ti njoftuar rreth gjendjes në të cilen ndodhet Komuna jonë.

**Pika e shtatë:** Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Sercan Todorovic tha: kërkojm nga antarët e Kuvendit që të biem një vendim për bartje të disa mjeteve që ti ndajm për blerje të materialit ndërtimor, ne më herët e kemi marr një venim por Ministria e Financave nuk e ka pranuar për arsye se në projektin të cilin kemi bërë bartjen nuk ka qenë projekt egzistues dhe mjetet duhet të barten vetëm në projekt egzistues.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli tha: vetëm më intereson të dij se për çfarë shume bëhet fjal?.

Sercan Todorovic tha: 20.000€ janë gjithësej, 10.000€ për material ndertimor dhe 10.000€ për mbikqyrje të projekteve.

Ramush Mehmeti tha: ne së pari si Kuvend duhet të biem një vendim për ta anuluar vendimin e mëhershëm dhe pastaj të biem një vendim të ri, është mirë të analizojm nese ka mundësi që ky buxhet të bartet në kode tjera, ju faleminderit.

Dobrivoje Djordjevic tha: për këtë pikë nuk po flas por në fshatin Stanishor është një problem tjtër hedhja e mbeturinav, të gjitha mbeturinat hedhen në fshatin Dtanishor dhe në gjithë fshatin egzistojn vetëm dy kontinjerë, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: kur ka të bëj me vendime të financave, materiali duhet të vij shtatë ditë më herët për ta analizuar bartjen e mjeteve e jo të pika të ndryshme ti bartim 20.000€ thuajse janë 20€, cili është projekti kapital?, ku shkojn ato mjete?, me arsyetimin se Qeveria i tërheq nuk ma mer menja se është shumë rrezik për arsye se ka afate kohore, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: ne nese deri në fund të muajit tetor nuk i shfrytëzoj do ti tërheq Ministria e Financave, këto jan mjete tona dhe ne kemi të drejt ti bartim vetem ne projekte egzistuese.

Kryesuesi tha: ne në maj kemi marrë një vendim për bartje të këtyre mjeteve prej kodit të ujësjellësit në ndërtim dhe mirëmbajtje të ndriqimit publik, pasi që Ministra nuk e ka lejuar këtë bartje atëher ta shtym këtë pikë për mbledhjen e ardhshme në mënyrë që të analizojm më shumë.

Xhejlane Behluli tha: në mbledhjen e mbajtur me 21 maj 2018 është marrë vendimi për bartje të këtyre mjeteve në ndriqim publik, keni mundur ti shfrytëzoni këto mjete apo jo deri sa ju është kthyer përgjigja prej Ministrisë dhe na tregoni Drejtor se deri kur kemi hapsirë apo duhet sot patjetër të votohet.
Sercan Todorovic tha: mbledhja e ardhshme e Kuvendit është me 27 deri sa të dërgohet vendimi në Ministri dhe Ministria të kthej përgjigjje është von pasi deri në fund të tetorit duhet të caktohen mjetet të cilat do të shpenzohen andaj ne në këtë mbledhje duhet të biem vendim për bartje të këtyre mjeteve.
Kryesuesi kërkoj 10min pauz për konsultim.
Pas pauzes 10minutshe Kryesuesi j dha fjalen Drejtorit të Financave për sqarime shtesë.
Sercan Todorovic tha: më herët kemi marrë vendim për bartje të mjetve në vlerë prej 30.000€, por 10.000€ na ka marrë përmbaruesi privat, kan mbetur 20.000€ të cilat janë në Drejtori të Zhvillimit Ekonomik, së pari duhet të mirret një vendim për anulim të vendimit të mëhershëm dhe pastaj të votohet për bartje të këyre mjetev, ne sot duhet ta biem këtë vendim për arsye të hapsires kohore në mënyr që të kem mundësi ti shfrytëzojm.
Xhejlane Behluli tha: pajtohem që të baten këto mjete.
Kryesuesi tha: a kemi mundësi që ti bartim në ndonjë projekt tjtër apo vetem aty?.
Sercan Todorovic tha: kërkesat më të mëdha janë për material ndërtimor dhe propozimet i kemi që të barten aty.
Mirjana Simijonovic pasi përshendeti të pranishmit tha: pasi që një pjesë e këtyre mjetev po ndahet për material ndërtimore e kisha pyetur Drejtorin pasi mendoj që kishe qenë mirë që të formohet një komision nga Kuvendi që të kemi qasje edhe ne, ju faleminderit.
Milica Jovanovic pasi përshendeti të pranishmit tha: çfarë ka ndodhur me komisionin e formuar për ndarje të mjetve për vjedhje të kafshëve?.
Ramush Mehmeti tha: pas sqarimeve që na ofroj Drejtori paska mundësi mu investu edhe në kanalizim, nuk besoj që situata është kaq kriteke që të votohet sot, propozoj që kjo pikë të shtyhet që të bëhet një analizë më e mirëfilltë.
Xhejlane Behluli tha: mendoj se ne duhet të vendosim në mënyr që mos ti humbim ato mjete, jam për mos me u shty kjo pikë.
Abdyl Gashi tha: është e dyta apo e treta herë që votojm dhe niveli qendror i kthen mbrapa vendimet e Kuvendit, mos të përseritemi prap sepse është edhe një paaftësi e Kuvendit e cila merr vendime të kunderligjshme, nuk po e shef se po citon ndonjë nen i cili po na jep mundësi me i bart këto mjete.
Mirjana Simijonovic tha: ju Drejtor ishit shumë i qartë nuk e di sa mjete mundë ti ndani por ne kërkuam që të formohet një komision, në mënyr që të dim se sa mjete dhe kujt po i ndahen.
Kryesuesi tha: mendoj ashtu si zv.Kryesuesi që të bëhet një analizë më e mirë.
Driton Mustafa pasi përshendeti të pranishmit tha: ne vitin e kaluar e kemi hartuar këtë projekt në vlerë prej 30.000€ për këtë vit, këto mjete për investim kemi pasur ti investojm në ujësjellës ashtu siç ka qenë e planifikuar dhe ka qenë kërkesë e qytetarëve, mirëpo pasi që Kryetari i Komunës ka nënshkruar një marrëveshje me CDF Zviceran për furnizim me ujë të pijshëm që do të investojn ata ku ka nevoj ne e kemi parë të arsyeshme që këto mjete ti transferojna në hartimin dhe mirëmbajtjen e ndriqimit publik të cilin vendim e kemi marrë në muajin maj dhe ky vendim është marrë në mënyr shumë të drejt, ne e kemi dërguar kërkesen në Ministri të Financave dhe ju kemi trerguasr arsyen e bartjes së këtyre mjeteve, por ne për vitin 2018 projekt të planifikuar për ndriqim publik nuk kemi pasur për këtë arsye nuk është lejuar që ti bartim këto mjete. Para disa muajve përmbaruesi privat në mënyr të padrejt na ka terhequr 10.000€ prej atij kodi për një faktur, kan mbetur 20.000€ dhe ne këto mjete duhet ti transferojm në të njejten Drejtori për material ndertimor dhe për ndertim dhe mbykqyrje të projektit, këto mjete i ka planifikuar Kryetari i Komunës së bashku me menaxherin e projektit, për mos me shku suficit dhe në vitin e ardhëshem mos me hi në obligme në investime kapitale ne duhet ti bartim në këto projekte, sa i përket projektit të kanlizimeve ne e kemi në zvvillim ekonomik që është ne vlerë prej 40.000€, dhe nuk kem arsye këto mjete mi bart aty, kështu që ne këtë vendim duhet ta marim dhe këto mjete duhet të dërgohen ne furnizim me

material ndertimor dhe mbykqyrje dhe hartim të projekteve, sa i përket komisionit nuk duhet të formohet nga Kuvendi Komunal pasi që komisioni është i formuar prej Komunës dhe ju mundë të kërkoni prej atij komisioni se ku shkojn ato mjete, ju faleminderit.
Selatin Nuhiu tha: 10.000€ të cilat i ka terhequr përmbaruesi tregon se nuk ka menxhim të mirë dhe nuk i përmbahen afatit të pagesave.
Mirjana Simijonovic tha: një pikë e till mos të jet te të ndryshmet por të jet e panifikuar në rend dite dhe të marrim materialin me kohë.
Kryesuesi tha paraprakisht të votojm për anulim të vendimit të mëhershëm.
Pasi nuk pat diskutime tjera aprovohet me 11 vota për, 1 apstenim antarët prezent të Kuvendit kjo pikë dhe u pru ky:

**V E N D I M**

Për Anulimin e Vendimi, 01/252 nga data 05.06.2018 për transferim të mjetev financiare nga Kategoria për Investime Kapitale nga kodi 47195 Ndërtimi i Ujësjellësit pran Drejtoris për Zhvillim Ekonomik vlera prej 30.000 €, të tranferohen në kodin për Ndërtimi dhe Mirëmbajtjen e ndriqimit publik pran drejtoris së njejtë.
Kryesuesi e pyeti Drejtorin e Financave se prej cilit kod ne cilin do të barten këto mjete ?.
Kryesuesi tha : tash votojm për shtyerje të kësaj pike.
Me 9 vota për 3 kundër aprovohet nga antëret e Kuvendit kjo pikë që të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Kryesuesi pyeti se a ka diskutime tjera ?.
Xhevat Mehmeti Drejtori i Inspeksionit pasi përshendeti të pranishmit tha: pasi që jam kryetari i komisionit për dhënje në shfrytëzim të pronës komunale, ju njoftoj se e kam një kërkes urgjente nga një shoqat e bletarve të Prekovcit, unë e kam kërkesen në gjuhen serbe nese deshironi mund tju lexoj por pasi që është urgjente pasi që projketin e ka fituar në vlerë prej 15.000€ nga një organizatë, pasi që është lokal dhe nuk është pron kisha kërku nga ju që ta përkrahni në mënyr që mos të humb projektin, ju faleminderit.
Ramush Mehmeti tha: nese mundë të na tregoni për cilin objekt bëhet fjalë ?.
Xhevat Mehmeti tha: bëhet fjal për një objekt ne fshtin Prekovc dmth zyrja për komunitete e cila nuk shfrytëzohet.
Kryesuesi tha: cilat janë procedurat për dhënje të tokës në shfrytëzim pasi që ju jeni kryetar i Komisionit.
Xhevat Mehmeti tha: është fjala për dhënje të lokalit dhe jo pronës.
Milica Jovanovic tha: kush është themeluesi i kësaj shoqate të bletarisë?.
Xhevat Mehmeti tha: Ivomir Bogdanovic.
Xhejlane Behluli tha: unë e përkrahi këtë propozim.
